

## ULLIRI DHE PRODHIMI I VAJIT TË ULLIRIT

Sektori i ullirit dhe vajit të ullirit është një segment i rëndësishëm i prodhimit primar dhe i agroindustrisë shqiptare. Në Shqipëri kultivohen 10.94 milion rrënjë me ullinj, nga të cilët në prodhim janë rreth 9.16 milion rrënjë. Nga të dhënat statistikore analizohet që viti 2022 arriti një prodhim prej 158,710 ton ullinj, nga ku 28,848 ton janë ullinj tavoline dhe 128,861 ton janë ullinj për përpunim. Qarqet më potenciale janë Fieri me 2.86 milion rrënjë ullinj (26%), Berati me 2.02 milion rrënjë ullinj (18.4%), Vlora me 1.93 milion rrënjë ullinj (17.7%) dhe Elbasani me 1.76 milion rrënjë ullinj (16.1%).

## TREGU I EKSPORTIT TË VAJIT TË ULLIRIT

Bazuar në evidencat e FAO-s, Shqipëria ndërmjet viteve 1962-1967 ishte një nga 15 prodhuesit më të mëdhenj të vajit të ullirit në botë. Ndërkohë në Shqipëri operojnë rreth 400-450 njësi përpunimi ulliri nga të cilat 40% janë investime të reja dhe me një teknologji shumë të përparuar. Gjatë vitit 2022, rezultoi që prodhimi i vajit të ullirit ka qenë në sasinë më të lartë në vite, me rreth 29,000 ton.

Aktualisht, rreth 2000 ton janë eksportuar në mënyrë të formalizuar gjatë 4 muajve të parë të 2023. Por duke qenë se shumica e fermerëve nuk kanë **kushtet e duhura për të ruajtur vajin**, vlerat e tij ushqyese humbasin, ndaj janë detyruar ta shesin me një çmim rreth 400 lek/litri.

Andrea Carassi, Drejtor i Përgjithshëm i Shoqatës Italiane të Industrisë së Vajit Ushqimor (Assitol), ka paralajmëruar se Italia përsëri po përballë me një mungesë më të madhe të vajit të ullirit. "Ne jemi një vend ku pothuajse 600,000 ton vaj ulliri konsumohen në vit. Ne eksportojmë më shumë se 400,000 ton dhe tani po prodhojmë pak më shumë se 200,000 ton. Kjo do të thotë se rreth 80% e nevojave tona për vaj ulliri do të mbulohen nga importet"- tha z.Carrassi.

Mënyra e vetme e eksportit të vajit në sasi të mëdha është vetëm kooperimi dhe certifikimi në bazë grupi, në bazë kultivari. Cilësia e vajit të ullirit ndikohet nga i gjithë procesi që nga vjelja deri te shtrydhja dhe ruajtja në pajisje dhe ambiente të përshtatshme.

## “FERMERË, INVESTONI NË CISTERNË DHE ENË TË PËRSHTATSHME PËR RUAJTJEN E VAJIT TË ULLIRIT”

Nga kalkulimet që ekspertët e NOA-s kanë kryer, një fermer me 1 ha ullishte në prodhim, arrin të marrë rreth 7500 kg ullinj, konvertuar me 1250 litra vaj ulliri. Duke humbuar tregun e pajisjeve ruajtëse të vajit (<https://www.enoalba.com/vaji>, <https://www.megateksa.com/sq/bujqesi-dhe-blegtori>) vërejmë që ky investim përllëgaritet në një vlerë rreth 150,000 lekë në total dhe fermeri mund ta ruajë vajin e ullirit pa humbur vetitë ushqyese deri në 18 muaj. Për të gjithë fermerët që disponojnë vaj ulliri, kjo vlerë investimi ofrohet nga NOA, brenda një procesi një ditor, pa kolateral.

“NOA FINANCON, NOA KËSHILLON”

